



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 2401/3 prot.

Tiranë, më 26.12.2023

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 2401/1, DATË 20.09.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, "PËR ARKIVIMIN PAS VERIFIKIMEVE TË ANKESAVE TË BASHKUARA TË PARAQITURA NGA SHTETËSJA ZNJ. FLUTURA UKA"

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e znj. Flutura Uka, me nr.1621 prot., datë 04.03.2021, nr. 1621/2 prot., datë 20.04.2021 dhe nr. 1621/3 prot., datë 27.04.2021, në të cilat ngrihen pretendime ndaj magjistratëve A.K, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë, A.M. dhe A.H, me detyrë gjyqtarë në Gjykatën e Shkallës së Parë në kohën e kryerjes së shkeljes së pretenduar dhe me vendimin nr. 2401/1, datë 20.09.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për arkivimin pas verifikimit të ankesave të bashkuara të paraqitur nga shtetësja znj. Flutura Uka", bazuar në nenin 122, pika 4, të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t'i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Kamëz, sipas adresës së lënë nga ankuesi; Bulevardi Blu, pranë Big Market, Godina 195, hyrja 1, kati i 5, Kamëz;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al.

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

